

20151925276

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIMIN E
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113 /2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13 dhe 44/14), në nenin 77-g në paragrafin (3) fjala: “njëherë” zëvendësohet me fjalën “dyherë”.

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

“Në bazë të revizionit dhe azhurnimit të kryer në bazat e pyetjeve dhe bazat e shembujve praktik, Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, vendos së paku 30% e pyetjeve dhe bazave të shembujve praktik të ndryshohen ose plotësisht të mënjanohen dhe zëvendësohen me të reja në bazat nga neni 77-x të këtij ligji.”

Në paragrafin (9) pas fjalëve “i kryen Agjencia” shtohen fjalët: “për çka Këshilli i ekspertëve përcakton person përgjegjës nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit.”

Pas paragrafit (9) shtohet paragraf i ri (10), si vijon:

“(10) Personit përgjegjës nga paragrafi (9) i këtij neni për çdo sesion të mbajtur provimi për agjent i përket kompensim me para, në shumë prej një të tretës nga neto paga mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Këshilli i ekspertëve miraton aktvendim.”

Neni 2

Në nenin 77-d paragrafët (3) dhe (4) shlyhen.

Paragrafët (5) dhe (6) bëhen paragrafët (3) dhe (4).

Neni 3

Në nenin 77-gj paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Kandidatët të cilëve u është miratuar kërkesa për dhënien e provimit, shoqëria pensionale dhe publiku informohen për datën dhe kohën e mbajtjes së provimit, së paku tetë ditë para mbajtjes së provimit nëpërmjet ueb faqes së Agjencisë dhe Servisit Publik Radiodifuziv.”

Pas paragrafit (5) shtohen pesë paragrafë të rinj (6), (7), (8), (9) dhe (10) si në vijim:

“(6) Përfaqësuesve nga paragrafi (5) i këtij neni për çdo sesion të mbajtur të provimeve u përket kompensim, në shumë prej një të tretën e neto pagës mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Këshilli i ekspertëve miraton aktvendim.

(7) Personi i autorizuar juridik i cili teknikisht e zbaton provimin është i obliguar të bllokojë shtrirjen e radiofrekuencave në hapësirën për dhënien e provimit gjatë kohës së zbatimit të provimit për agjent.

(8) Agjencia për komunikime elektronike (në tekstin e mëtejme: AKE) zbaton monitorim të vazhdueshëm të bllokimit të shtrirjes së radiofrekuencave në hapësirën e dhënies së provimit, me qëllim të parandalohet çdo lloj i komunikimit elektronik me mjedisin e jashtëm nga hapësira për dhënien e provimit.

(9) AKE në hapësirën për dhënien e provimit instalon pajisje matëse e cila siguron regjistrim elektronik nga matjet e kryera në kohëzgjatje prej 30 ditëve, dhe të njëjtat grumbullohen në sistemin qendror kontrollues të AKE.

(10) AKE formon komision prej tre anëtarëve që përpilon raport në bazë të regjistrimeve elektronike të grumbulluara në sistemin qendror kontrollues të AKE dhe të njëjtin e parashtron në Agjencinë më së shumti në afat prej 30 ditëve nga data e mbajtjes së provimit për agjent.”

Neni 4

Në nenin 77-e në paragrafin (7) pas fjalës “termin” shtohen fjalët: “dhe i shqiptohet ndalesë për dhënien e provimit në kohëzgjatje prej tre viteve, për çka Agjencia miraton aktvendim kundër të cilit mund të ngrihet kontest administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.”

Neni 5

Në nenin 77-j paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

“(7) Komisioni nga paragrafi (6) i këtij neni mban mbledhje pas çdo sesioni të provimit dhe kryen revizion të zbatimit të provimit, për çka parashtron raport te kryetari i Këshillit të ekspertëve.”

Paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

“(8) Anëtarëve të komisionit nga paragrafi (6) i këtij neni u përket kompensim me para, që në nivel vjetor është një rrogë mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka Këshilli i ekspertëve miraton aktvendim.”

Neni 6

Neni 136-g ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në Agjencinë, nëse:

1) pranon funksion ose punësim ose fiton aksione në kundërshtim me nenin 51 paragrafi (7) i këtij ligji;

2) nuk miraton aktvendim në afatin e caktuar me nenin 77-j paragrafi (10) i këtij ligji dhe

3) vepron në kundërshtim me nenin 77-e paragrafi (9) i këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet personit përgjegjës në Agjencinë i cili konstaton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit nëse lejon të merr pjesë kandidat i cili nuk i plotëson kushtet e caktuara me këtë ligj.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’u shqiptohet përfaqësuesve të autorizuar nga neni 77-gj paragrafi (5) i këtij ligji nëse lejojnë kandidati të veprojnë në kundërshtim me nenin 77-e paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji.

(4) Gjobë në shumë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet kandidatit nëse vepron në kundërshtim me nenin 77-e paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji.

(5) Gjobë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’u shqiptohet anëtarëve të komisionit nga neni 77-j paragrafi (6) i këtij ligji, nëse konstatojnë parregullsi në zbatimin e provimit, kurse atë nuk e regjistrojnë në raportin për Këshillin e ekspertëve. “

(6) Për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksione për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

Neni 7

Neni 136-zh ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet personit të autorizuar i cili teknikisht e zbaton provimin nga neni 77-gj paragrafi (7) të këtij ligji nëse nuk e bllokoi shtrirjen e radio frekuencave në hapësirën për dhënien e provimit.

(2) Për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksione për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

(3) Llogaritja e lartësisë së gjobës për personin juridik nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”

Neni 8

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.